



Universiteti "Kadri Zeka" - Gjilan

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

Universiteti Public "KADRI ZEKA" Public Universit	
Profil i përgatitur	0112483
Ndëshkruar	29.12.2020
Ngjarje	

ASOCIACIONIT TË BIBLIOTEKAVE ELEKTRONIKE TË KOSOVËS

DHE

UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" NË GJILAN

Kjo marrëveshje është arritur në Gjilan më datë 29.12.2020 ndërmjet:

Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës (tash e tutje ABEK), në njëren anë dhe Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan në anën tjetër.

Në pajtim me këtë marrëveshje palët nënshkruese u morën vesh, si në vijim:

### Neni 1

Qëllimi i kësaj marrëveshje është anëtarësimi i Universitetit "Kadri Zeka" në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës dhe shfrytëzimi i burimeve dhe materialeve elektronike të nevojshme për përdoruesit e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan.

### Neni 2

Anëtarësimi i palës në ABEK ofron mundësinë e shfrytëzimit të burimeve elektronike të cilat sigurohen nga ABEK përmes EIFL për Kosovë, qoftë burime falas apo me pagesë.

### Neni 3

obligohet që në emër të anëtarësimit vjetor në ABEK të paguajë shumën 200 € (euro) e cila paguhet në llogarinë rrjedhëse të ABEK-ut.

### Neni 4

ABEK mban kontakte të vazhdueshme me anëtarët për informim rreth aktiviteteve, nevojave, prioriteteve dhe synimeve, si dhe u përgjigjet atyre.

### Neni 5

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan mban kontakt të vazhdueshme për informim me zyrën qendrore të ABEK-ut rrëth aktiviteteve, nevojave dhe synimeve të bashkëpunimit reciprok në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar.

### Neni 6

ABEK prezanton dhe përkrahë interesat e anëtarëve të tij në nivel të organizmave vendor dhe në nivele të tjera.

### Neni 7

ABEK krijon mundësitë për shfrytëzimin e burimeve elektronike të nevojshme për Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan përmes trajnimeve dhe botimeve me interes.

### Neni 8

Marrëveshja nënshkruhet në 2 (dy) kopje.

### Neni 9

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe zgjat për aq sa palët kontraktuese kanë interes dhe përbushin obligimet që dalin nga marrëdhëniet kontraktuale.

### Neni 10

Kjo marrëveshje shkëputet me paralajmërim 30 ditë përpara nëse ABEK nuk ofron informacione për të rejet rrëth burimeve elektronike.

Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të  
Kosovës


Bukurije Haliti, Koordinatore



Në Gjilan, më 29.12.2020

Universitetit "Kadri Zeka"  
Gjilan

Prof. Dr. Bajram Kosumi, Rektor



Në Gjilan, më 28.12.2020

